



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. DPKIDPKI	Nr Prot. Bi Prot Prot No 03-02/19/147
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages 02	Data Datum Date 27. 01. 2017
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.01.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4652/16, për z. Hasim Krasniqi, Zyrtar Kryesor i Prokurimit në Ndërmarrjen Publike “Telekomi i Kosovës” Sh.A, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Hasim Krasniqi - Zyrtar Kryesor i Prokurimit në Ndërmarrjen Publike “Telekomi i Kosovës” Sh.A dhe njëkohësisht ekspert dhe person i autorizuar në biznesin privat “HASIM KRASNIQI B.I.”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtarët e AKK-së kanë organizuar takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Krasniqi është bindur me fakte për gjendjen e konfliktit të interesit dhe ndryshimet që duhet ti bëjë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

z. Krasniqi ka deklaruar se biznesin privat e ka hapur për të ushtruar veprimtarinë private sepse është i licencuar nga Ministria e Financave si ekspert për vlerësimin e pronave të paluajtshme.

Lidhur me këtë, z. Krasniqi është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtroj veprimtari private të ekspertit sepse Ligji nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit e ndalon një gjë të tillë. Neni 16 (paragrafi 2) i këtij ligji shprehimisht thotë:

“Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë veprimtari private, si; avokatisë, noterisë, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave të përcaktuara në paragrafin 1, të këtij neni”.

Përveç kësaj, Agjencia kundër Korrupsionit, ka kërkuar nga zyrtari i lartë, të heq dorë nga ushtrimi i funksionit menaxherial në biznesin privat, për të shmangur këtë situatë.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar një shkresë zyrtare (DPKI.03-02/51/17), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në biznesin privat B.I “Hasim Krasniqi” si dhe një deklaratë me të cilën z. Krasniqi zotohet se, gjatë ushtrimit të funksionit publik, nuk do të ushtroj asnjë aktivitet me këtë biznes privat.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

